



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova

REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
QENDRA PËR SHËRBIM TË QYTETARËVE
CENTAR ZA USLUGU GRAJANA

Sh. 05 Nr. 30862
U. Br.
Nr. i faq. 1 Data: 03/11
Br. str. Datum: 2025
KAMENICË



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



IAAP „Andrea Durrsaku”
Nr.1347 dt.03.11.2025
Kamenicë

Në bazë të nenit 28 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-138 të datës 18.03.2013 për Arsimin dhe Aftësimin Profesional dhe në bazë të nenit 12 të Ligjit nr.04/L-143, të datës 13.10.2012, për Arsimin dhe Aftësimin e të Rriturve, drejtorja e Institucionit për Arsim dhe Aftësim Profesional “Andrea Durrsaku” në Kamenicë shpall:

K O N K U R S

PËR REGJISTRIM TË KANDIDATËVE NË ARSIMIN PËR TË RRITUR

- IAAP „Andrea Durrsaku” shpall konkursin për regjistrim të kandidatëve në arsimin për të rritur, të cilët kanë mbaruar shkollimin fillor të obligueshëm ose kanë mbaruar ndonjë vit të shkollës së mesme.
 - Për regjistrim mund të konkurojnë kandidatët të cilët i kanë mbushur 18 vjet.
 - Kandidatët e interesuar të cilët i plotësojnë kushtet e parapara me këtë konkurs mund të regjistrohen në klasën e X, XI, XII në drejtime dhe profile si në tabel:

Nr.	Drejtimi	Profili arsimor	Vende të lira
1.	Elektroteknikë	Informatikë	20
		Telekomunikacion	20
		Energjitikë	20
2	Makineri.prodhim dhe ndërtimtari	Instalues elektrik	16
3	Makineri	Automekanik	16
		Mekanik i makinave	16
4	Makineri.prodhim dhe ndërtimtari	Metalpunues	16
		Instalues i UK-NK	16
5	Kimi - teknologji	Laborant i kimisë	20
6	Ekonomi	Banka dhe sigurime	20
		Kontabilitet dhe tatime	20
7	Makineri.prodhim dhe ndërtimtari	Ndërtimtari	20
		Arkitekturë	20



- Regjistrimi i kandidatëve në programin “Arsimi për të rritur”, bëhet sipas procedurave të njëjta të regjistrimit për nxënësit e rregullt, siç është paraparë në Ligjin nr.04/L-143 për Arsimin dhe Aftësimin për të Rritur në Republikën e Kosovës dhe Udhëzimeve Administrative të MASHTI-it.
- Në programin “Arsimi për të rritur” në shkollat e mesme të larta, kandidatëve ju mundësohet që një vit të plotë shkollor ta përfundojnë në afat prej 18 javë mësimi në bazë të Udhëzimit Administrativ 13/2014 të datës 05.05.2014
- **Kandidatët për regjistrim duhet t’i dorzojnë këto dokumente::**
 - Dëftesë mbi kryerjen e shkollimit fillor të obligueshëm (kandidatët që kanë të kryer ndonjë klasë të shkollës mesme duhet të dorëzojnë dëftesën e klasës së fundit).
 - Çertifikatë e lindjes
- Shkollimi në nivelin e arsimit të mesëm të lartë për këta vijues është me pagesë. Participimi bëhet në bazë të rregullores nr. 01/2017 të nenit 12 të datës 02.02.2017 për Planifikimin dhe shpenzimin e të hyrave vetanake të realizuara nga institucionet e arsimit dhe aftësimin profesional dhe arsimit për të rritur
- **Pagesa e rexhistrimit për vijuesit e arsimit për të rritur**

a) Për rexhistrimin të vitit (për një klasë 100 €)	100 €
b) Për praktikë profesionale.....	50 €
c) Provim diferencial.....	10 €
d) Provim pëfundimtar-diploma.....	50 €
- Pagesa bëhet në institucionet përkatëse sipas kodit të shkollës
- Vijuesit të cilët ndërrojnë profilin, do t’u nënshtrohen provimeve diferenciale, bazuar në UA 13/2014 ,dt: 05.05.2014 të MASHTI. Kandidatët, të cilët ndërrojnë drejtimin , janë të obliguar që paraprakisht t’u nënshtrohen provimeve plotësuese dhe diferenciale.
- Dhënia e provimeve plotësuese dhe diferenciale bëhet në afat të veçantë
- Dëftesat dhe diplomat që merren në programin “Arsimi dhe aftësimi për të rritur “ janë të barasvleshme me diplomat e arsimit profesional.
- Konkursi është i hapur 15 ditë, nga dita e publikimit në mjetet e informimit publik



Agon Mahmuti